



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 4 par. 4.3 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për bujqësi 15 Nr.400-12011 të datës 04.03.2016, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHPËRNDARJEN E FIDANEVE TË MJEDRES ME
SISTEM TË UJITJËS DHE SERRAVE

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shpërndarjen e fidaneve të mjedres me sistem të ujitjës dhe serrave (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, kryesues
2. Bekim Arifi, Drejtorati për Prokurim, anëtar
3. Ymer Bikliqi, Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që s'bashku me operatorin ekonomik të bëjë dorëzimin e fidaneve të mjedres dhe vendosjen e sistemit të ujitjës si dhe të serrave për secilin përfitues.

Dorëzim pranimin e fidaneve të mjedres me sistem të ujitjës si dhe serrave do të bëhet me Procesverbal të nënshkruar nga Komision dhe përfituesi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 320-36090
Lipjan, më 07.07.2016



KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

Imri Ahmeti